



100 Vjet Shtet Shqiptar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Tel: 2 270 630, Fax: 2 270 627 www.moe.gov.al

Ngjesh 90

07.01.2013

UDHËZIM

Nr. 2, datë 7.01.2012

PËR
TREGUESIT, MËNYRAT E VLERËSIMIT, RREGULLAT DHE KËRKESAT
TEKNIKE E METODIKE PËR VLERËSIMIN E NIVELIT TË ZHURMËS, SI DHE PËR
VERIFIKIMIN E NDËRHYRJEVE TË BËRA PËR ZGJIDHJEN DHE PËRMIRËSIMIN
E GJENDJES

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis";

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e nivelit të zhurmave të ditës, mbrëmjes dhe natës (L_{dmn}) i cili do të llogaritet sipas formulës të pikës 1 të Aneksit 1 bashkëngjitur.
2. Përcaktimi i indikatorit të zhurmës gjatë natës do të bëhet sipas standarteve ISO të pikës 2, të Aneksit 1 bashkëngjitur.
3. Metodat e ndërmjetme të llogaritjes për zhurmën që vjen nga industria, trafiku ajror, trafiku rrugor dhe ai hekurudhor do të bëhet sipas standarteve ISO, të pikës 2.2 të Aneksit 2.
4. Për vlerësimin e nivelit të zhurmës, si dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për zgjidhjen dhe përmirësimin e gjendjes do të përdoren marrëdhëniet dozë-efekt, të cilat pasqyrohen në Aneksin 3 bashkëngjitur.
5. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
6. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Fatmir MEDIU



ANEKSI I

Mënyra e vlerësimit të Indikatorëve të Zhurmave

Përkufizime

- **Ngjarje me zhurmë** konsiderohet ajo ngjarje ku zhurma zgjat më pak se 5 minuta, psh zhurma e një treni apo aeroplani në kalim e sipër);
- **NET** është niveli i Ekspozimit ndaj Tingullit;
- **Ld**: është niveli mesatar i ponderuar në shkallën A gjatë gjithë periudhave të ditës të vitit, sipas standardeve ISO 1996-2:1987;
- **Lm**: është niveli mesatar i ponderuar në shkallën A gjatë gjithë periudhave të mbrëmjes të vitit sipas standardeve ISO 1996-2:1987;
- **Ln**: është niveli mesatar i ponderuar në shkallën A gjatë gjithë periudhave të natës të vitit, sipas standardeve ISO 1996-2:1987, ku:
- **Dita** ka 13 orë, mbrëmja 4 orë dhe nata 7 orë;
- **Dita zgjat** nga ora 06.00 deri 19.00, mbrëmja zgjat nga 19.00 deri 23.00 dhe nata zgjat nga 23.00 deri 06.00 të kohës lokale;
- **Viti** është një vit përfaqësues nga pikëpamja e emisioneve të zhurmës, dhe
- **Viti është mesatar** nga pikëpamja e zhurmave që lidhen me kushtet meteorologjike.

1. Përcaktimi i nivelit të zhurmave të ditë-mbrëmje-natës (L_{dmn}).

Niveli i zhurmave të ditë-mbrëmje-natës L_{dmn} në decibel (dB) llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$L_{dmn} = 10 \lg \frac{1}{24} \left(13 * 10 * \frac{L_d}{10} + 4 * 10 * \frac{L_m + 5}{10} + 7 * 10 * \frac{L_n + 10}{10} \right)$$

- Në këtë formulë përdoret niveli i tingullit rënës ose niveli i korigjuar me vlerën e tingullit që reflektohet nga fasada e ndërtesës. Në rastin e matjeve, kjo do të thotë që niveli i tingullit duhet korigjuar me një vlerë prej 3dB që është kontributi i reflektimit.

Lartësia e pikës së vlerësimit të L_{dmn} zgjidhet sipas nevojës:

- Kur bëhen llogaritje për qëllime të hartëzimit strategjik të zhurmës lidhur me ekspozimin ndaj zhurmës në ndërtesa dhe afër tyre, pikat e vlerësimit duhet të jenë $4,0 \pm 0,2$ m (3,8 deri 4,2 m) mbi tokë dhe në fasadën më të ekspozuar. Në këtë rast fasada më e ekspozuar do të jetë muri i jashtëm ballor që ndodhet më afër burimit specifik të zhurmës. Për qëllime të tjera mund të zgjidhen lartësi të ndryshme.
- Kur bëhen matje për qëllime të hartëzimit strategjik të zhurmës, në lidhje me ekspozimin ndaj zhurmës në ndërtesa dhe afër tyre, mund të zgjidhen lartësi të tjera, por asnjëherë më pak se 1,5 m mbi tokë, dhe rezultatet duhen korigjuar në përputhje me një lartësi ekuivalente të lartësisë 4m.

- Për qëllime të tjera si planifikimi akustik dhe zonimi i zhurmës, mund të zgjidhen lartësi të tjera, por asnjëherë më pak se 1,5 mbi tokë, për shembull për:
- Zonat rurale me shtëpi një katëshe;
- Përcaktimi i masave lokale që synojnë reduktimin e ndikimit të zhurmës në ndërtesa të vecanta;
- Hartëzimi i detajuar i zhurmës për një zonë të kufizuar, që tregon ekspozimin e ndërtesave të veçanta ndaj zhurmës.

2. Përcaktimi i indikatorit të zhurmës gjatë natës.

Indikator i zhurmës gjatë natës – L_n , është niveli mesatar i tingullit sipas matjeve afat-gjata të bëra gjatë gjithë periudhave të natës gjatë një viti, i ponderuar në shkallën A, sipas standardeve ISO 1996-2:1987 dhe përkufizimeve të mësipërme.

3. Indikatorët plotësues të zhurmës.

Në disa raste, përveç indikatorëve L_{dmin} dhe L_n , apo L_d dhe L_m , mund të përdoren edhe indikatorë të vecante të zhurmës dhe vlerat kufi që lidhen me to, si më poshtë:

- **Përqindja e kohës**, gjatë së cilës punon burimi i zhurmës ndaj kohës së përgjithshme të periudhës së ditës apo të natës gjatë një viti, në rastin kur burimi i zhurmës në shqyrtim punon vetëm për një kohë të kufizuar (p.sh më pak se 20%) .
- **numri mesatar i ngjarjeve me zhurmë** në një apo më shumë periudha, kur ky numër është shumë i vogël (p.sh më pak se një ngjarje me zhurmë në një orë.
- **banda e frekuencave të ulta të zhurmës**, kur kjo është dominuese në spektrin e zhurmës,
- L_{Amax} , apo NET, për mbrojtjen nga zhurma gjatë natës, kur kjo e ka pikun (niveлин maksimal) gjatë natës;
- mbrojtje shtesë në fundjavë apo periudha të caktuara gjatë vitit;
- mbrojtje shtesë gjatë ditës;
- mbrojtje shtesë gjatë mbrëmjes;
- një kombinim zhurmash nga burime të ndryshme;
- zona të qeta në vende të hapura;
- zhurma përmban komponentë tonesh të fortë (frekuencash të larta);
- zhurma ka karakter impulsiv.

ANEKSI II

METODAT E VLERËSIMIT TË TREGUESVE TË ZHURMËS

1. Hyrje

Vlerat e indikatorëve L_d dhe L_n mund të përcaktohen me anë të llogaritjeve ose me anë të matjeve të kryera në vendin, për të cilin vlerësohet niveli i zhurmës. Për qëllime parashikimi zbatohen vetëm metodat me llogaritje.

Metodat me llogaritje dhe ato me matje siç kërkohen nga dispozitat e Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” paraqiten në paragrafet 2 dhe 3.

2. Metodatat e ndërmjetme të llogaritjes për L_{dnn} dhe L_n .

2.1. Adoptimi i metodave llogaritëse nacionale.

Metodat që do të përdoren me definicionet e dhëna në Aneksin I.

Këto metoda marrin në konsideratë mbrëmjen si një periudhë e vecantë dhe futjen e saj në vlerësime, mbështetur në mesataren e një viti të dhënë. Këto metoda mund të përfshijnë ose të përjashtojnë reflektimin e fasadës, si dhe futjen në llogaritje të natës si një periudhë e vecantë dhe/ose pozicionin (pikën) ku bëhet vlerësimi. Përcaktimi i mesatares gjatë vitit kërkon vëmendje të posaçme. Ndryshimet në emision dhe transmetim mund të kontribuojnë në luhatjet gjatë një viti.

2.2 Rekomandimi i metodave të ndërmjetme të llogaritjes.

Metodat kombëtare të llogaritjes mbështeten në metodat e rekomanduara nga Direktiva 2002/49/EC si me poshtë:

Për **zhurmën nga industria**: ISO 9613-2: 'Akustika - Zvogëlimi i tingujve të jashtëm, Pjesa 2: Metoda e përgjithshme e llogaritjes.

Të dhënat e nevojshme për emisione të zhurmës (të dhëna hyrëse) me këtë metodë mund të merren në matjet e kryera në perputhje me një nga metodat vijuese:

- ISO 8297: 1994 “Akustika - Përcaktimi i niveleve të fuqisë së tingullit nga impiantet industriale me shumë burime për vlerësimin e presionit të niveleve të zhurmës në mjedis - Metoda inxhinierike”.
- EN ISO 3744: 1995 “Akustika - Përcaktimi i niveleve të fuqisë së zhurmës duke përdorur presionin e tingullit - Metoda inxhinierike në një fushë esencialisht të lirë mbi një plan reflektues”.

Për zhurmën nga aeroplanët: ECAC, CEAC Doc 29 “Raporti mbi Metodatat Standarde për

llogaritjen e kontureve të Zhurmës rreth Aeroporteve Civile” 1997. Do të përdoren qasje të ndryshme për modelimin e shtigjeve të fluturimit dhe teknikën e segmentimit që përmendet në seksionin 7.5 të ECAC.CEAC Doc 29.

Për zhurmën nga komunikacioni rrugor: Metoda e llogaritëse kombëtare e Francës “NMPB - Rrugët -96 (SETRA-CERT-LCPC-CSTB)”, i referohet në 'Arrete du 5 mai 1996 relatif au bruit des infrastructures routieres, Journal Officiel du 10 mai 2995, Neni 6 dhe në standardet e Francës 'XPS 31-133'. Për të dhëna hyrëse mbi emisionet, këto dokumente kanë për referencë “Guide du bruit des transports terrestres, fascule prevision des niveaux sonores, CETUR 1980'.

Për zhurmën nga hekurudhat: Metoda e llogaritëse kombëtare e Hollandës, publikuar në “Reken-en Meetvoorshrift Railverkeerslaëaai” 96, Ministerie Volkshuisvesting, Ruimtelijke Ordening en Milieubeher, 20 November 1996.

3. Metodatat e ndërmjetme të matjes për Ldmn dhe Ln .

Metodat e matjes në përdorim do të mbështeten në definicionet e indikatorëve të vendosur në Aneksin I dhe në përputhje me parimet e matjeve të mesatarizuara për një kohë të gjatë matjesh të përcaktuara në ISO 1996-2, 1987 dhe ISO 1996-1, 1982.

Të dhënat e matjes para fasadës apo ndonjë elementi tjetër reflektues duhet të korrigjohen për të përjashtuar kontributin e reflektimit të fasadës apo elementit në fjalë (si rregull, kjo nënkupton në rastet e matjeve një korrigjim prej 3dB).

ANEKSI III

METODAT E VLERËSIMIT PËR NDIKIMET E DËMSHME

Për të vlerësuar ndikimin e zhurmës në popullatë përdoren mardhëniet dozë-efekt. Mardhëniet dozë-efekt duhet të përqëndrohen vecanërisht në:

- marrëdhënien midis bezdisë dhe Ldmn për zhurmat nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror si dhe për zhurmat industriale,
- marrëdhënien midis prishjes (shqetësimit) së gjumit dhe Ln për zhurmat nga trafiku rrugor, hekurudhor dhe ajror si dhe për zhurmat industriale.

Sipas nevojës, marrëdhënie të tjera të veçanta të efektit dozë-pasoje mund të paraqiten edhe për:

- banesa me izolime speciale kundër zhurmës,
- banesa me fasadë të qetë,
- grupe të ndjeshme të popullatës,
- zhurmat qe vijnë nga zonat e percaktuara si industriale,
- zhurmë industriale impulsive dhe
- raste tjera te vecanta.